



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA DURRËS  
KËSHILLI BASHKIAK

Durrës më 16.01.2026

**RAPORT**  
**PËR PUNËN E KËSHILLIT TË BASHKISË PËR 12 - MUJORIN E**  
**VITIT 2025**

Të nderuar këshilltarë !

Ky raport vjetor përgatitet në zbatim të detyrimeve ligjore, veçanërisht në ligjin nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar, i cili përcakton rolin, kompetencat dhe përgjegjësitë e Këshillit si organ përfaqësues dhe vendimmarrës në nivel vendor si dhe në Rregulloren e Funksionimit të Këshillit të Bashkisë Durrës, miratuar me Vendim nr.25, datë 29.04.2020. Gjithashtu, raporti hartohet në përputhje me parimet e transparencës dhe të së drejtës për informim, të sanksionuara në ligjin nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, si dhe në respektim të kërkesave për raportimin e veprimtarisë publike. Në këtë kuadër, paraqiten të dhëna dhe vlerësime mbi mbledhjet e zhvilluara, vendimet e miratuara, dhe çështjet kryesore të trajtuara gjatë vitit raportues. Nëpërmjet këtij raporti, Këshilli synon jo vetëm të informojë publikun dhe institucionet përkatëse mbi punën e kryer, por edhe të krijojë një bazë reference për përmirësimin e vazhdueshëm të qeverisjes vendore, forcimin e besimit publik dhe rritjen e eficiencës së ushtrimit të kompetencave ligjore në të ardhmen.

Këshilli i Bashkisë Durrës, gjatë 12-mujorit të vitit 2025 është fokusuar në trajtimin e problemeve dhe shqetësimeve që meritonin vëmendjen e duhur për një shërbim sa më cilësor ndaj komunitetit. Ka marrë vendim çdo muaj për dhënie ndihme financiare, për familje, jo vetëm nga fondi i kushtëzuar por edhe nga të ardhurat e Bashkisë Durrës si më poshtë :

Nr.	Muaji	Ndihmë ekonomike për familje nga të ardhurat e Bashkisë	Ndihmë ekonomike për familje nga fondi i kushtëzuar 6 %
1.	Janar	-	-
2.	Shkurt	81	0

3.	Mars	92	30
4.	Prill	118	30
5.	Maj	132	34
6.	Qershor	132	39
7.	Korrik	132	38
8.	Gusht	134	37
9.	Shtator	136	36
10.	Tetor	135	41
11.	Nëntor	137	40
12.	Dhjetor	137	39

Kemi akorduar bonus strehimi si dhe ulje të vlerës së kontratës për familjet që përmbushnin kriteret ligjore për të përfituar nga fondet e akorduara nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë në favor të Bashkisë Durrës, gjithsej :

365 familje bonus strehimi per subvencionim te qirasë (VKB. Nr.48)

11 familje ulje të vlerës së kontratës ( VKB. Nr. 49)

(ku përmendim invalidë, persona PAK, familje të komunitetit egjiptian ose rom, persona që gëzojnë statusin e jetimit, apo kryefamiljare të divorcuara).

Gjithashtu këshilli ka marrë vendim për 412 familje që kanë përfituar nga program i kredisë së lehtësuar për strehim me 3% interes ( VKB nr.78).

Në zbatim të aktit normativ nr.8, datë 07.12.2019 dhe aktit normativ nr.9, datë 16.12.2019 Këshilli i Bashkisë Durrës, ka marrë vendime për periudhën janar - dhjetor 2025 për tërmetin gjithsej 14 vendime, në krahasim me 36 të vitit të mëparshëm, ku pjesa më e madhe është për miratimin e listave të përfituesve nga programi i rindërtimit apo ndryshim të VKB.

*Krahas këtyre vendimeve kemi miratuar vendime për :*

- Sistemin e pikëzimit për përzgjedhjen e familjeve, që kërkojnë të përfitojnë nga programet e strehimit social (VKB nr.2).
- Dhënien e autorizimit për nënshkrimin e aktmarrëveshjes së financimit ndërmjet sipërmarrësit “Dule” shpk dhe përfituesit Bashkia Durrës, për rikonstruksionin e qendrës shëndetësore Rrashbull, njësia administrative Rrashbull, bashkia Durrës (VKB nr.4).
- Miratimin e kërkesës për transferimin përfundimtarë të pronës apo dhe kalim inventari të varrezave të njëjësive tek NSHK (VKB nr.17,18,19,68).
- Hartën e plazheve dhe plotësimi me elementët e nevojshëm. (VKB nr.24).
- Funkcionimit të qendrës “Fuqizojmë komunitetin” me mbështetjen nga programi i fondit social të buxhetit të shtetit për vitet 2025-2027 dhe buxheti i Bashkisë Durrës (VKB nr.31).
- Për miratim të vlerave të shpronësimeve, TID, Ishëm (VKB nr.32,76)
- Për zhvillimin e pronës përreth kompleksit të Stadiumit (VKB nr.35).
- Për dhënien e miratimit të nënshkrimit të marrëveshjes së bashkëpunimit midis Bashkisë Durrës dhe Spitalla Solar shpk (VKB nr.36).

- Fond për furnizimin me orendi e pajisje të shkollës së mesme të përgjithshme Manëz, njësi administrative Manëz, sipas projektit “Fv orendi e pajisje gjimnazi Manëz” (VKB nr.59).
- Miratimin e marrëveshjes për krijimin e personit juridik si subjekt i kompetencave të përbashkëta midis njësive të vetëqeverisjes vendore dhe Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë për rritjen e kapaciteteve të qeverisjes vendore, Akademia e Trajnimit të Njësive të Vetëqeverisjes Vendore të Republikës së Shqipërisë (TALGA) (VKB nr.60).
- Për përcaktimin e zonave të administrimit të parkimit dhe tarifave . (VKB nr.61).
- Për krijimin e Këshillit Vendor të Sigurisë Publike në bashkinë Durrës dhe miratimin e rregullores për organizimin dhe funksionimin e tij (VKB nr.65).
- Udhëzuesit për mënyrën e aplikimit “Për implementimin e skemës: grante për të rinjtë në mbështetje të zhvillimit të iniciativave ekonomike lokale” (VKB nr.66).
- Ndihma Financiare lidhur me dëmet nga zjarret apo përmbytjet. (VKB nr.67,75)
- Për sistemin e taksave dhe tarifave vendore në qytetin e Durrësit për vitin 2025. (VKB nr.74)
- Buxhetin e vitit 2026 dhe projektbuxhetin afatmesëm të Bashkisë Durrës për vitet 2026-2028 (VKB nr.73)
- Bursat për nxënësit e arsimit parauniversitar, profesional dhe konviktet e shkollave të mesme profesionale . (VKB nr.7, 80)
- Gjithashtu Këshilli ka marrë dhe disa vendime që i përkasin mbarëvajtjes së punës së tij. (VKB nr. 25,26,54,62,71,81,82)

#### **Vlen të përmendet fakti se gjatë këtij viti Këshilli Bashkiak miratoi plane si më poshtë:**

1. Planin e masave për parandalimin dhe menaxhimin e zjarreve në pyje e kullota të bashkisë Durrës për vitin 2025 (VKB nr.9).
2. Plani i veprimit të qëndrueshëm për energjinë dhe klimën (SECAP) të bashkisë Durrës 2030. (VKB nr.45).
3. Plani social 2025-2028 të bashkisë Durrës.(VKB nr.55).
4. Plani i arsimit parauniversitar 2026-2028 në bashkinë Durrës. (VKB nr.56).

Për 3(tre) planet e fundit mbetet për detyrë implementimi i tyre në praktikë dhe për të arritur sa më mirë këtë duhet bashkëpunimi i të gjithë hallkave (përfaqësues, ekzekutiv, komunitet)

#### **Për periudhën janar – dhjetor 2025, janë marrë 82 vendime gjithsej në Këshillin Bashkiak Durrës.**

*(Sqarim : Bashkëngjitur materialit gjeni dosjen e vendimeve ku është përcaktuar saktë numri i vendimit, data e vendimit, data e shpalljes së vendimit, titulli i vendimit, data e miratimit nga Prefekti dhe nr.i fletëve të vendimit dhe dokumentave shoqëruese të tij, të cilat janë të publikuara dhe në faqen e internetit të Këshillit)*

#### **Nga karakteri i vendimeve mund t’i ndajmë në:**

- |                                   |                     |
|-----------------------------------|---------------------|
| <b>1. për probleme financiare</b> | <b>- 11 vendime</b> |
| <b>2. për probleme sociale</b>    | <b>- 14 vendime</b> |

3. për infrastrukturën dhe strehimin - 25 vendime
4. për problemet urbane dhe asetet - 13 vendime
5. për emergjencat civile - 3 vendime
6. për probleme të arsimit kulturës - 4 vendime
7. të ndryshme - 12 vendime (nga këto 7 për KB-ak)

Numrin më të madh të vendimeve e përbëjnë vendimet që kanë të bëjnë me infrastrukturën dhe strehimin. Ky dominim lidhet drejtëpërdrejtë me faktin se çështjet për strehimin dhe infrastrukturën përfaqësojnë nevoja themelore dhe prioritare për komunitetin, veçanërisht në kontekstin e proceseve të rindërtimit dhe përmirësimit të kushteve të jetesës.

Për vendimet e marra nga ky këshill për 12 mujorin e vitit 2025 institucioni i *Prefektit të Qarkut Durrës* është shprehur pozitivisht për shprehjen e ligjshmërisë ndaj tyre për 48 akte normative, 33 është shprehur se janë akte individuale dhe për 1 vendim (VKB nr.79) është shprehur se nuk është kompetencë e Këshillit Bashkiak, por e Kryetarit të Bashkisë.

Nga Prefektura Durrës është kryer kontroll sipas legjislacionit në fuqi dhe në raportet përfundimtare është cilësuar se Këshilli Bashkiak Durrës ka zbatuar me korrektësi të gjitha detyrimet ligjore.

Nga sa thamë më lart, këto vendimmarrje të këshillit, flasin qartë për bashkëpunimin e Këshillit me administratën e Bashkisë për t'iu përgjigjur në kohë dhe sipas legjislacionit në fuqi gjithë shqetësimeve dhe problematikave të komunitetit të Durrësit.

### **Ndryshime në përbërjen e Këshillit Bashkiak gjatë vitit 2025:**

Gjatë vitit 2025, dy këshilltarë humbën mandatin për shkak të zgjedhjes si deputetë në Kuvendin e Shqipërisë (zgjedhjet parlamentare 11 maj 2025):

- Ani Dyrmishi – zëvendësuar nga Kastriot Xhongoli (nga e njëjta listë partiake).
- Manjola Luku – zëvendësuar nga Mirela Shala (nga e njëjta listë partiake).

Këto zëvendësime u miratuan nga Këshilli në mbledhjen e [shtator dhe nëntor 2025], pas propozimit të Komisionit të Mandateve.

### **Mbledhjet e Këshillit dhe Komisioneve të Përhershëm .**

Këshilli gjatë kësaj periudhe ka mbajtur 9 mbledhje të radhës, 4 mbledhje jashtëradhe dhe nuk ka mbajtur asnjë mbledhje të jashtëzakondshme, sipas tabelës së mëposhtëme:

<b>Muaji</b>	<b>Nr i mbledhjeve</b>	<b>Mbledhje të radhës</b>	<b>Mbledhje jashtë radhe</b>	<b>Mbledhje të jashtëzakondshme</b>
Janar	-	-	-	-
Shkurt	1		1 (11.02.2025)	-

Mars	1	1 (10.03.2025)	-	-
Prill	1	1 (30.04.2025)	-	-
Maj	1	-	1 (21.05.2025)	-
Qershor	2	1 (11.06.2025)	1 (23.06.2025)	-
<b>Total 6 mujor parë</b>	<b>6</b>	<b>3</b>	<b>3</b>	<b>-</b>
Korrik	3	1 (03.07.2025) 2 (18.07.2025 dhe 23.07.2025)	-	-
Gusht	-	-	-	-
Shtator	1	1 (10.09.2025)	-	-
Tetor	-	-	-	-
Nëntor	1	1 (11.11.2025)	-	-
Dhjetor	2	1 (23.12.2025)	1 (4.12.2025)	-
<b>Total 6 mujor dytë</b>	<b>7</b>	<b>6</b>	<b>1</b>	<b>-</b>
<b>Total 12 mujori</b>	<b>13</b>	<b>9</b>	<b>4</b>	<b>-</b>

Më poshtë prezantohet kalendari i mbledhjeve me oraret e mbajtjes së seancave plenare dhe vëndin e mbajtjes së tyre.

Kalendari i zhvillimit të mbledhjeve paraqitet si më poshtë :

<b>6 mujori parë 2025</b>	<b>Nr.</b>	<b>DATA E MBLEDHJES</b>	<b>ORA</b>	<b>VENDI I ZHVILLIMIT</b>
	1.	11.02.2025	12:00	Salla e Këshillit Bashkiak
	2.	10.03.2025	12:00	Salla e Këshillit Bashkiak
	3.	30.04.2025	12:00	Salla e Këshillit Bashkiak
	4.	21.05.2025	12:00	Salla e Këshillit Bashkiak
	5.	11.06.2025	14:00	Salla e Këshillit Bashkiak
	6.	23.06.2025	12:00	Salla e Këshillit Bashkiak

<b>6 mujori dytë 2025</b>	1.	03.07.2025	13:00	Salla e Këshillit Bashkiak
	2.	18.07.2025 (shtyhet)	10:00	Salla e Këshillit Bashkiak
	3.	23.07.2025	11:00	Salla e Këshillit Bashkiak
	4.	10.09.2025	13:00	Salla e Këshillit Bashkiak
	5.	11.11.2025	12:00	Salla e Këshillit Bashkiak
	6.	04.12.2025	12:00	Salla e Këshillit Bashkiak
	7.	23.12.2025	12:00	Salla e Këshillit Bashkiak

Numri total i mbledhjeve plenare të mbajtura: **13** (duke llogaritur 3 në korrik, pra duke përfshirë dhe atë që u shty).

- Pjesëmarrja mesatare në sallë: rreth **35.5** këshilltarë për mbledhje. Shumica e mbledhjeve kanë qenë midis 65-80 % të pjesëmarrjes (duke përfshirë atë që u shty).
- **Pjesëmarrja mesatare në përqindje: 69.6%.**
- Më e larta: 80% (mars) – 41 këshilltarë.
- Më e ulëta: 45% (korrik, ajo që u shty) – 23 këshilltarë.

Komisionet e përhershme të këshillit janë mbledhur për të diskutuar dhe miratuar projektvendimet e sjella nga administrata e Bashkisë Durrës. Për periudhën 12-mujore janë mbajtur 68 mbledhje të komisioneve të përhershëm.

<b>Nr.</b>	<b>Muaji</b>	<b>Mbledhjet e Komisioneve të Përhershëm</b>
1.	Janar	-
2.	Shkurt	2
3.	Mars	6
4.	Prill	5
5.	Maj	4
6.	Qershor	14
	<b>Total 6 mujori I-rë</b>	<b>31</b>
7.	Korrik	12
8.	Gusht	-
9.	Shtator	6
10.	Tetor	-
11.	Nëntor	7
12.	Dhjetor	12
	<b>Total 6 mujori II-të</b>	<b>37</b>
	<b>TOTALI 12 MUJOR</b>	<b>68</b>

Gjatë kësaj periudhe Komisionet i kanë mbajtur mbledhjet e tyre në Sallën e Këshillit apo Zyrën e Sekretarisë së Këshillit. Theksojmë se anëtarët e komisioneve që i përkasin pakicës në këshill nuk kanë qenë shumë prezent në mbledhjet e komisioneve.

Në çdo rast Komisionet e Përhershme në zbatim të “Rregullores së funksionimit të Këshillit të Bashkisë Durrës” kanë mbajtur raport apo procesverbal ku pasqyrohet vendimmarrja e secilit komision për pikat e rendit të ditës, që u janë caktuar për t’i shqyrtuar, sipas tabelës së mëposhtëme:

Nr.	Komisioni	6 mujori parë 2025					
		RAPORTE E PROÇESVERBALE TE KOMISIONEVE sipas pikave të rendit të ditës					
		Janar	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qershor
1.	Komisioni Strehimit dhe Shërbimeve Publike	-	1r/1p	-	-	1r/1p	1r/4p
2.	Komisioni Zhvillimit Urban dhe Përdorimit të Tokës	-	-	1r/1p	1r/1p	-	1r/2p +1r/1p
3.	Komisioni Mandateve	-	-	-	-	-	2pv/2p
4.	Komisioni i Rregullores, Çështjeve Juridike	-	-	1r/3p	1r/4p	1r/2p	1r/12p + 3 pv/3p të propozuara +2r/3p
5.	Komisioni Buxhetit, Financës dhe Taksave-Tarifave	-	-	1r/1p	1r/1p	1r/1p	1r/2p
6.	Komisioni Mbrojtjes Civile, Sigurisë Publike, Emergjencave Civile dhe Shëndetësisë	-	-	-	1r/2p	-	-
7.	Komisioni Kulturës, Arsimit, Rinisë, Sporteve, Komuniteteve Fetare dhe Titujve të Nderit	-	-	1r/1p	-	-	1r/1p
8.	Komisioni i Mardhënieve me Jashtë dhe Integrimi Evropian	-	-	-	-	-	-
9.	Komisioni Mjedisit dhe Trajtimit të Mbetjeve	-	-	-	-	-	-
10.	Komisioni Barazisë Gjinore dhe Mirëqënies Sociale	-	1r/1p	1r/1p	1r/2p	1r/1p	1r/2p

11.	Komisioni i Pronave Publike, Transportit dhe Trafikut Rrugor	-	-	1r/2p	-	-	1r/4p +1r/1p
12.	Komisioni i Politikave të Zhvillimit Ekonomik	-	-	-	-	-	-
13.	Komisioni i Politikave të Zhvillimit të Turizmit	-	-	-	-	-	1r/1p
14.	Komisioni Etikës, Apelimeve, Konfliktit të Interesit, Peticioneve	-	-	-	-	-	-
15.	Komisioni i Teknologjisë dhe Inovacionit	-	-	-	-	-	-
	<b>Totali 6 mujori I-rë</b> <b>31 ku janë 5 pv</b>	-	<b>2</b>	<b>6</b>	<b>5</b>	<b>4</b>	<b>14</b>
<b>Nr.</b>	<b>Komisioni</b>	<b>6 mujori dytë 2025</b> <b>RAPORTE E PROCESVERBALE TË KOMISIONEVE</b> <b>sipas pikave të rendit të ditës</b>					
		<b>Korrik</b>	<b>Gusht</b>	<b>Shtator</b>	<b>Tetor</b>	<b>Nëntor</b>	<b>Dhjetor</b>
1.	Komisioni Strehimit dhe Shërbimeve Publike	1mb*3r/3p+ 2mb*14r/14p	-	1r/1p	-	1r/1p	1r/1p
2.	Komisioni Zhvillimit Urban dhe Përdorimit të Tokës	1r/2p	-	-	-	-	2r/2p
3.	Komisioni Mandateve	-	-	1pv/1p	-	1pv/1p	-
4.	Komisioni i Rregullores, Çështjeve Juridike	1mb*1r/4p + 2mb*2r/16p	-	1r/7p	-	1r/3p	1r/2p +1r/8p
5.	Komisioni Buxhetit, Financës dhe Taksave-Tarifave	1r/1p	-	1r/2p	-	1r/1p	4r/4p
6.	Komisioni Mbrojtjes Civile, Sigurisë Publike, Emergjencave Civile dhe Shëndetësisë	-	-	-	-	1r/1p	1r/1p
7.	Komisioni Kulturës, Arsimit, Rinisë, Sporteve, Komuniteteve Fetare dhe Titujve të Nderit	1m*2r/2p	-	1r/2p	-	1r/1p	1r/1p

8.	Komisioni Mardhëniese me Jashtë dhe Integrimi Evropian	-	-	-	-	-	-
9.	Komisioni Mjedisit dhe Trajtimit të Mbetjeve	1r/1p	-	-	-	-	-
10.	Komisioni i Barazisë Gjinore, Mirëqënies Sociale dhe Mosdiskriminimit	1r/1p	-	1r/2p	-	2r/2p	1r/1p +1r/1p
11.	Komisioni i Pronave Publike, Transportit dhe Trafikut Rrugor	1r/1p	-	-	-	-	2r/2p
12.	Komisioni i Politikave të Zhvillimit Ekonomik	-	-	-	-	1r/2p	-
13.	Komisioni i Politikave të Zhvillimit të Turizmit	-	-	-	-	-	1r/1p
14.	Komisioni Etikës, Apelimeve, Konfliktit të Interesit, Peticioneve	-	-	-	-	-	-
15.	Komisioni i Teknologjisë dhe Inovacionit	-	-	-	-	-	-
16.	<b>Totali 6 mujori II-të</b> <b>57 ku janë 2pv</b>	<b>27</b>	<b>-</b>	<b>6</b>	<b>-</b>	<b>8</b>	<b>16</b>

***Sqarim** : Mbledhjet e komisioneve janë më pak se raportet në 6 mujorin e dytë pasi komisionet kanë bërë 1 mbledhje, por në atë mbledhje një komision ka shqyrtuar më shumë se 1 pikë sipas rendit të ditës dhe ka paraqitur raporte për secilën pikë që ka shqyrtuar*

<b>Nr.</b>	<b>Periudha</b>	<b>Raporte/Procesverbale/Projektvendime të Komisioneve të Përhershëm</b>
1.	Totali 6 mujori I-rë	<b>31</b>
2.	Totali 6 mujori II-të	<b>57</b>
	<b>Totali 12 mujor</b>	<b>88</b>

Komisioni i Mandateve ka propozuar 4 projektvendim dhe 4 relacion, që janë bërë vendime.

VKB nr. 25, datë 11.06.2025

VKB nr. 26, datë 11.06.2025

VKB nr. 54, datë 10.09.2025

VKB nr. 62, datë 11.11.2025

Komisioni i Rregullores, Çështjeve Juridike ka propozuar 3 projektvendim dhe 3 relacion, që janë bërë vendime.

VKB nr. 20, datë 11.06.2025

VKB nr. 21, datë 11.06.2025

VKB nr. 22, datë 11.06.2025

Zv/Kryetari i Këshillit ka propozuar 1 projektvendim dhe 1 relacion, miratuar nga konferenca e kryetarëve që është bërë vendim.

VKB Nr. 71, datë 04.12.2025

Propozim i Grupit Partisë Socialiste .

VKB Nr. 81, datë 23.12.2025 (Zgjedhja Kr)

VKB Nr. 82, datë 23.12.2025 (Zgjedhja Zv/Kr)

*Këshilli për 2025 ka pasur një buxhet të miratuar 700.000 lekë.*

Më datë 17.12.2025, një delegacion i Këshillit Bashkiak Durrës zhvilloi vizitë studimore në Këshillin Bashkiak Shkodër me qëllim shkëmbimin e përvojave për funksionimin e këshillit, transparencën dhe pjesëmarrjen qytetare.

Gjatë takimeve me kryetarin e këshillit dhe komisionet u diskutuan praktika të mira në organizimin e seancave, konsultimet publike dhe digjitalizimin e proceseve. U fituan ide të vlefshme për përmirësimin e rregullores, rritjen e transparencës dhe forcimin e bashkëpunimit me qytetarët.

Vizita u vlerësua shumë pozitive dhe u shpreh interes për bashkëpunim të vazhdueshëm mes dy këshillave.

*Në zbatim të programit të transparencës raportojmë si më poshtë :*

Në zbatim të Programit të Transparencës dhe në përmbushje të detyrimeve ligjore për informimin e publikut, Këshilli Bashkiak Durrës ka përditësuar dhe strukturuar faqen e tij zyrtare online, duke garantuar akses të gjerë, të lehtë dhe të vazhdueshëm të qytetarëve në informacionet që lidhen me organizimin, funksionimin dhe veprimtarinë e Këshillit Bashkiak. Faqja online e Këshillit Bashkiak shërben si një platformë informimi dhe ndërveprimi me publikun, e ndarë në kartela tematike, si më poshtë:

- Rreth Keshillit Bashkiak
- Historiku i kryetarëve
- Struktura e Këshillit Bashkiak
- Anetaret e Këshillit Bashkiak
- Perberja e Komisioneve
- Konferenca e Kryetarëve
- Legjislacioni
- Rregulloret
- Model formatesh për t'u shkarkuar nga komuniteti
- Kalendar i Mbledhjeve Të Këshillit
- Model formati për t'u shkarkuar nga Këshilltari në rast konflikt interesi
- Proçesverbalet e mbledhjeve të KB
- Projekt-Vendimet e Këshillit Bashkiak
- Vendime Të Këshillit Bashkiak
- Njoftime të Këshillit Bashkiak
- Rrjete sociale të Këshillit Bashkiak
- Konsultimet Publike
- Projekt-vendimet në proçes shqyrtimi nga Këshilli Bashkiak
- Raporte të Këshillit

- Raporte të Komisioneve të Këshillit
- Regjistri elektronik i kërkesave, ankesave dhe vërejtjeve
- Regjistri i brendshëm i peticioneve dhe iniciativave qytetare
- Regjistri publik për transparencën e mbledhjeve të Këshillit Bashkiak
- Regjistri i projekt akteve per konsultim publik të këshillit Bashkiak
- Dëgjesa Publike
- Buxheti i Këshillit
- Pyetësor për Buxhetin
- Buxheti për Qytetarët
- Aktivitetet e Këshillit
- Këshilli në Vite

Në tërësi, faqja online e Këshillit Bashkiak Durrës përfaqëson një instrument të rëndësishëm të transparencës, llogaridhënies dhe pjesëmarrjes qytetare, duke siguruar akses për publikun në informacion, dokumentacion dhe procese vendimmarrëse, në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi dhe standardet e qeverisjes së mirë.

Sekretariati i Këshillit ka zbatuar me korrektësi kërkesat e ligjit për njoftimet publike ( *si në faqen zyrtare të Bashkisë, në media vendore, me email drejtuar OJF, Drejtorëve të bashkisë, Kryetarëve të Njësisë Administrative, në këndin e informacionit në zyrën e mardhënieve me publikun në Bashkinë Durrës*) në zbatim të ligjit 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, i ndryshuar dhe Rregulloren e Funksionimit të Këshillit të Bashkisë Durrës.

Në protokollin e Sekretariatit kanë hyrë 152 shkresa zyrtare dhe kanë dalë 110 shkresa zyrtare. *(sqarojmë se disa shkresa nuk kanë patur nevojë për përgjigje pasi kanë qenë për dijeni drejtuar kryetarit apo këshilltarëve të cilëve sekretariati ia ka vënë në dijeni përmes postës elektronike apo dhe fletëthirrje gjyqi).*

Këshilli duke ju përshtatur dhe risive të teknologjisë për përçimin sa më shpejt të njoftimeve apo komunikimit direkt me qytetarët, në zbatim të rregullores për paraqitjen dhe shqyrtimin e kërkesave ankesave, peticioneve dhe iniciativave qytetare, e bën trajtimin e tyre transparente në faqen zyrtare të këshillit bashkiak në ”Regjistrin elektronik të kërkesë-ankesave”.

Gjithashtu, këshilli ka dhe faqen e tij në *rrjetin social facebook* në të cilin bën njoftimet për mbledhjet e tij si dhe merr vërejtje, ankesa, kërkesa e sygjerime nga qytetarë të ndryshëm. Në funksion të rritjes së transparencës dhe komunikimit të drejtpërdrejtë me qytetarët, Këshilli Bashkiak Durrës transmeton live mbledhjet e tij edhe në faqen zyrtare në Facebook, duke u dhënë mundësi qytetarëve t’i ndjekin seancat në kohë reale, pavarësisht vendndodhjes së tyre. Ky transmetim i drejtpërdrejtë siguron informim të menjëhershëm mbi diskutimet dhe vendimmarrjet e Këshillit Bashkiak, rrit aksesin publik në proceset vendimmarrëse dhe forcon ndërveprimin me komunitetin, duke përmbushur standardet e transparencës dhe llogaridhënies në nivel vendor.

Nuk kanë munguar as takimet direkte të këshilltarëve me banorët e Bashkisë Durrës dhe përcjellja e mendimeve të tyre në mbledhjet e komisioneve dhe në seancat plenare të këshillit. Gjithashtu në çdo mbledhje plenare të radhës në fund të çdo mbledhje është lënë një hapësirë për pyetje nga komuniteti (kërkesa apo ankesa, diskutime), që janë përcjellë përmes pyetjeve që kanë bërë Këshilltarët drejtuar

administratës së Bashkisë, të cilat kanë marrë përgjigje të drejtëpërdrejtë nga administrata e bashkisë dhe janë pasqyruar në procesverbalet e mbledhjeve plenare.

Gjithashtu, *Regjistri Publik për Transparencën e Mbledhjeve* të Këshillit Bashkiak Durrës përbën një instrument thelbësor të garantimit të transparencës, llogaridhënies dhe informimit të publikut mbi veprimtarinë vendimmarrëse të Këshillit Bashkiak. Ky regjistër, i publikuar dhe i aksesueshëm online në faqen zyrtare të Bashkisë Durrës, dokumenton në mënyrë të strukturuar dhe kronologjike të gjitha mbledhjet e Këshillit Bashkiak, duke mundësuar ndjekjen e plotë të procesit që nga njoftimi paraprak, zhvillimi i mbledhjes, deri te dokumentacioni përfundimtar që rrjedh prej saj. Në kuadër të zbatimit të ligjit nr. 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, i ndryshuar, regjistri siguron publikimin paraprak të informacionit mbi datën, orën, rendin e ditës dhe formatin e mbledhjeve të Këshillit Bashkiak, duke u dhënë qytetarëve dhe palëve të interesuara mundësinë të informohen në kohë dhe të ndjekin çështjet që diskutohen dhe vendimet që merren. Nëpërmjet këtij regjistri, qytetarët kanë akses të drejtëpërdrejtë jo vetëm në njoftimet dhe rendin e ditës, por edhe në procesverbalet e mbledhjeve, vendimet e marra duke rritur ndjeshëm nivelin e qartësisë së procesit vendimmarrës. Regjistri shërben gjithashtu si një arkiv institucional i qëndrueshëm, i cili ruan historikun e mbledhjeve të Këshillit Bashkiak ndër vite dhe mundëson gjurmueshmërinë e vendimmarrjes, analizën e proceseve dhe monitorimin nga qytetarët, shoqëria civile, media dhe aktorë të tjerë të interesuar.

Në zbatim të ligjit nr. 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, i ndryshuar, si dhe ligjit nr. 146/2014 “Për njoftimin dhe konsultimin publik”, gjatë periudhës 12-mujore të këtij viti, Këshilli Bashkiak Durrës, në bashkëpunim të ngushtë me administratën e Bashkisë, ka garantuar zhvillimin e proceseve të konsultimit publik, për pika të veçanta të rendit të ditës, si plani social, plani i arsimit parauniversitar, buxheti, taksat, paketa e maleve..etj.), në përputhje me parimet e transparencës, pjesëmarrjes qytetare dhe përfshirjes gjithëpërfshirëse në vendimmarrjen vendore.

Konsultimet e mësipërme janë zhvilluar si në Bashkinë Qendër, ashtu edhe në njësitë administrative të Bashkisë Durrës, por dhe nëpërmjet mjeteve të komunikimit elektronik. Në total, në këto konsultime kanë marrë pjesë 352 pjesëmarrës. Nga pjesëmarrësit janë dhënë rreth 73 rekomandime për të gjitha temat e konsultimit. Vlen të përmendet fakti se pjesa më e madhe e propozimeve nga komuniteti u reflektuan në buxhetin e Bashkisë Durrës për vitin 2026.

Në lidhje me rolin mbikqyrës dhe monitorues të Këshillit u paraqitën në këshill “Raporte të Bashkisë Durrës” në zbatim të VKB nr.111, datë 16.12.2024. Do ishte e nevojshme një bashkëpunim dhe një angazhim më i madh për ekzekutivin që të pregatisë në kohë raportet dhe informacionet e planifikuara për vitin 2026 me VKB nr.71, datë 04.12.2025, por edhe për rastet kur do të kërkohen nga këshilli.

Del si detyrë që çdo këshilltar për aktet normative, të cilat do të diskutohen dhe vendosen në këshill, të marrë opinionet dhe vërejtjet e publike në lagjjen ose fshatin që ata përfaqësojnë para se të gjykohet apo shqyrtohet për të. Të garantojnë që komentet e publikut të merren parasysh në vendimarrje. Të kontribuojnë në informimin e qytetarëve për të drejtën e tyre për t’u konsultuar dhe për mënyrat e pjesëmarrjes.

Në përfundim, veprimtaria e Këshillit gjatë vitit raportues dëshmon një angazhim të përqendruar në ushtrimin e përgjegjësive ligjore dhe në adresimin e çështjeve me ndikim të drejtpërdrejtë në jetën e qytetarëve. Vendimmarrja e orientuar kryesisht drejt infrastrukturës dhe strehimit reflekton nevojën për ndërhyrje të qëndrueshme dhe të mirëkoordinuara në këto fusha prioritare, si dhe rolin aktiv të Këshillit në mbështetjen e proceseve zhvillimore dhe sociale në nivel vendor.

Punë të mbarë për vitin 2026 dhe faleminderit për kontributin e secilit prej jush!

- Falenderimet gjithashtu shkojnë për Administratën e Bashkisë Durrës dhe znj.Eneida Marku koordinatorë e projektit “Bashki të Forta”.